



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 64

Prishtinë, më 21.12.2012, ora 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Anton Quni, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

Munguan: Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 21.11.2012;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-173 për përgjimin e telekomunikimeve;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 21.11.2012;

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 21.11.2012, i cili u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - amendamenteve për Projektligjin nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil

Kryetari i Komisionit- Për këtë projektligj ka punuar grupi punues i kryesuar nga z. Anton Quni, dhe për këtë qëllim fjalën ia kaloi z. Quni.

Anton Quni- Tha se Projektligji për Agjencinë e Regjistrimit Civil, është shqyrtuar në dy punime të grupit punues, dhe është bërë riformulimi i disa neneve. Gjithsej janë katërmëdhjetë amendamente, prandaj konsideroj që ky draft me amendamente mund të votohet në Komision dhe më pas të paraqitet në Kuvend.

Gjithashtu shtoi se për amendamentet e propozuara, është një dileme e shprehur nga z. Fatmir Xhelili, nenin 12 të Projektligjit, që ka të bëjë me buxhetin e Agjencisë, për të cilin nen është bërë riformulimi si në vijim, *“Kryeshefi i Agjencisë është përgjegjës për menaxhimin efektiv të buxhetit të Agjencisë, në pajtim me ligjin dhe rregullat e brendshme buxhetore të Ministrisë”*

Propozimi është që ky paragraf të hiqet dhe Agjencia të varet drejtpërdrejtë nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Tutje shtoi se nëse nuk ka vërejtje të tjera, mund të miratohen propozim amendamenteve për Projektligjin për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Rexhep Selimi- Propozoi që me që ka disa dilema për disa amendamente, dhe me që nuk ka kufizime kohore për procedimin tutje të këtij projektligji, kjo çështje të mbetet për takimet e radhës së Komisionit, ku të jetë prezent edhe z. Fatmir Xhelili.

Kryetari i Komisionit- Gjithashtu mbështeti propozimin që, me që ka një dilemë për projektligjin në fjalë, kjo çështje të mbetet në mbledhjen e radhës së Komisionit ku pas konsultimit me z. Xhelili, mund të jepet version i përfundimtar. Për këtë çështja ranë dakord të gjithë anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-173 për përgjimin e telekomunikimeve.

Kryetari i Komisionit- Me që ky ligj përbën një ndër ligjet e ndjeshme dhe të rëndësishme të Kosovës, tha se në këtë takim mund të jepen mendime, duke mos marrë

vendim sot, pasi duhet bërë një analizë më e detajuar këtij projektligji, në mënyrë që të konstatohet nëse aprovohet në lexim të parë duke bërë amendamentimin e tij, apo kthehet në Qeveri.

Rexhep Selimi- Marrë parasysh natyrën sensitive të ligjit dhe divergjencave deri në ardhjen e këtij ligji në Komision, tha se Komisioni duhet ti bëjë një analizë të veçantë dhe të ketë konsensus në qëndrime për këtë çështje.

Prandaj e konsideroi të rëndësishme, analizimin e këtij projektligji, përgjegjshmërinë në këtë proces, profesionalizmin dhe se shqyrtimi në parim i këtij projektligji të mos bëhet vetëm në këtë takim, por ti jepet kohë për tu analizuar.

Anton Quni- Tha se pajtohet me propozimin, që këtij ligji t'i kushtohet rëndësi e veçantë, dhe se për të qenë sa më profesional kërkoi që nga stafi mbështetës të sigurohen ekspertët në fushën teknike gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, për të ditur më mirë procedurat e përgjimit, regjistrimit etj.

Ky projektligj përmban fusha për të cilat jo të gjithë anëtarët kanë informacione, gjithashtu ka fusha të cilat nuk janë trajtuar, siç është mbrojtja e privatësisë së qytetarëve, prandaj e konsideroi të rëndësishme parapërgatitjen në këtë fushë.

Ganimete Musliu- Duke e marrë parasysh natyrën e projektligjit dhe kohën që është proceduar në Komision, tha se pajtohet me propozimin që duhet kohë për shqyrtimin e tij. Gjithashtu konsideroi se për të gjitha vendimet e marra në komision ka ekzistuar konsensus dhe se një gjë të tillë kërkoi edhe për vitin vijues dhe pajtohet që për këtë projektligj të merret me shumë kohë, duke shfrytëzuar mbështetjen profesionale dhe të ekspertëve të kësaj fushe.

Kryetari i Komisionit- Konsideroi se nga kjo që u deklarua, kjo pikë e rendit të ditës shërbeu si informatë që Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve është proceduar në Komision, gjithashtu konsideroi se duhet parë afati ligjor për procedimin tutje të tij. Mbështetje profesionale nga ana e ekspertëve e konsideroi të rëndësishme, në mënyrë që ligji të jetë i aplikueshëm. Ndërsa në takimin e parë të Komisionit të vitit 2013, Projektligji për përgjimin e telekomunikimeve të jetë në shqyrtim në parim, për të cilën gjë ranë dakord të gjithë anëtarët e Komisionit.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisioni- Ftoi anëtarët e Komisionit nëse kanë çështje për të ngritur në këtë pikë të rendit të ditës.

Anton Quni- Nga takimi i kaluar me Ministrin e Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi, tha se ka ngritur shqetësimin për çështjen e gradimeve në Policinë e Kosovës, për gradën e Nënkolonelit. Nga disa tregues dhe informacione, ky proces ka pasur parregullsi, ndërsa nga ana e Ministrit u deklarua se Komisioni mund të ketë qasje në dokumentacione dhe kontakt me eprorët që e kanë përbërë Komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve, për të parë nëse kjo procedurë ka qenë në rregull.

Çështja e dytë që ngriti, ishte që nga mediat është mësuar që Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është duke punuar për të bërë verifikimin e sigurisë e të gjithë pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, prandaj e konsideroi të nevojshme që për këtë qëllim të ketë informatë zyrtare nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

Kryetari i Komisionit- Për çështjet e ngritura nga z. Quni tha se, mund tu bëhet shkresë zyrtare nga ana e Komisionit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, me qëllim që një grup nga Komisioni që të mund të ketë qasje në dokumentacionin dhe informacionin e ofruara nga MPB-ja.

Rasim Demiri- Tha se përkrah qëndrimin e anëtarëve të Komisionit për procesin e gradimeve në Policinë e Kosovës, gjithashtu e konsideron të nevojshme të mbikëqyrret edhe procesi i gradimeve për minoritetet që e përbëjnë policinë.

Kryetari i Komisionit- Tha se pjesë e këtij grupi mund të jetë edhe z. Rasim Demiri, me që ka shpreh interesim për këtë çështje. Ndërsa për çështjen e verifikimit të sigurisë për zyrtarët policor nga ana e AKI-së, propozoi dërgimin e një kërkesë me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, për çështjen e verifikimit të zyrtarëve policor dhe se për çfarë qëllimi bëhet ky verifikim.

Rexhep Selimi- Tha se në rast se procesi i verifikimit të sigurisë për zyrtarët policor është konfidencial, për këtë çështje duhet të marrim përgjigjeje me shkrim, se ky proces nuk mund të mbikëqyrret nga Komisioni. Gjithashtu mbështet propozimin për krijimin e grupit mbikëqyrës për procesin e gradimeve në Policinë e Kosovës, dhe propozoi që ky grup të udhëhiqet nga z. Anton Quni.

Kryetari i Komisionit- Propozoi që krijimi i grupit punues mbikëqyrës për procesin e gradimeve në Policinë e Kosovës, të mbetet për mbledhjen e radhës së Komisionit.

Ganimete Musliu- Mbështet idenë për krijimin e grupit punues për mbikëqyrjen e procesit të gradimeve në Policinë e Kosovës, gjithashtu propozoi që në të ardhme e afërt të posedohet edhe një raport për gradimet nga ana e FSK-së.

Kryetari i Komisionit- Tha se në takimin e radhës do të ketë një raportim të përgjithësuar nga ana e Ministrit të FSK-së, z. Agim Ceku dhe Komandanti i FSK-së, Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati, ku edhe për këtë çështje mund të pyeten.

Rexhep Selimi- Propozoi që i njëjti grup punues mbikëqyrës, që do të mbikëqyr çështjen e gradimeve në Policinë e Kosovës, mund të bëjë edhe mbikëqyrjen e procesit të gradimeve në FSK.

Kryetari i Komisionit- Propozoi që pas raportimit nga ana e Ministrit të FSK-së, Komisioni mund të filloj me këtë proces, i cili mbetet për vitin vijues.

Anton Quni- Nëse e marrim përsipër edhe mbikëqyrjen e procesit të gradimeve në FSK, konsideroi se kjo punë është më komplekse, duke iu referuar rangjeve të ndryshme të gradimeve dhe periudhave të ndryshme kohore dhe se nuk ka informacion se mund të ketë pasur ndonjë shkelje gjatë procesit të gradimeve në FSK, prandaj konsideroi se duhet një përgatitje nga ana e grupit punues për këtë çështje.

Kryetari i Komisionit- Propozoi që fillimisht të bëhet mbikëqyrja e procesit të gradimit në Policinë e Kosovës, dhe më pas të vazhdohet me procesin e gradimeve në FSK. Gjithashtu njoftoi se të hënën mund të jetë takimi i Komisionit me Ministrin e FSK-së, z. Agim Çeku dhe raportimin e tij, prandaj kërkoi që anëtarët të jenë prezent.

Goran Marinković- Tha se për shkak të angazhimit që ka me Komisionin që udhëheq, nuk mund të jetë i pranishëm në takimin e radhës së planifikuar të Komisionit për në ora 12:00, prandaj kërkoi një koordinim për kohën. Gjithashtu shtoi se përkrah qëndrimin e anëtarëve të Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të gradimeve në Policinë e Kosovës dhe në FSK, në mënyrë që në rast se ka pasur shkelje gjatë këtij procesi të reagohet nga ana e Komisionit, duke propozuar që procesi i mbikëqyrjes të jetë një dhe jo i ndarë në dy pjesë, për mbikëqyrjen e gradimeve në polici dhe në FSK.

Kryetari i Komisionit- Kërkoi që për anëtarët e Komisionit të bëhet njoftimi me kohë dhe në koordinim me agjendën e tyre, me qëllim që të jenë prezent në takim.

Rexhep Selimi- Kërkoi që të dihet agjenda e punës së Komisionit për vitin vijues, dhe datën e fillimit të takimit të Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Propozoi që orientimisht data 15 janar 2013, të jetë data e fillimit të punës së Komisionit. Gjithashtu kërkoi nga anëtarët që të shqyrtojnë projektligjet që janë paraqitur në Komision, në mënyrë që kur të bëhet shqyrtimi dhe amendamenti i tyre në Komision të jemi të përgatitur.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi